

VENDIM
Nr. 212, datë 9.9.2025

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 148, DATË 8.7.2025, “MBI PEZULLIMIN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË ‘SUNPRO’ SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.9.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1848/18 prot., datë 3.9.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 148, datë 8.7.2025, “Mbi pezullimin e vendimarrjes së bordit të ERE lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘SunPro’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 148, datë 8.7.2025, vendosi: “Të pezullojë afatin e vendimarrjes për kërkesën e shoqërisë “SunPro” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 mw, me vendndodhje në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë”, duke i lënë detyrë shoqërisë që të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda datës 30.9.2025.

- Ky vendim u mor në rrethanat që shoqëria nuk ishte pajisur ende me miratimin përfundimtar, pra marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., për pikën e lidhjes së centralit eolik me rrjetin e transmetimit.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimarrjen e mësipërme me shkresën nr. 1648/16 prot., datë 15.7.2025.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1648 prot., datë 28.8.2025, shoqëria ka depozituar në ERE kërkesën e paraqitur në OST sh.a. në datën 12.8.2025 për marrjen e ofertës së lidhjes së parkut eolik me kapacitet 3 mw me rrjetin e transmetimit, duke konsideruar se me këtë dokument ka përmbushur dhe angazhimin e saj për plotësimin e dokumentacionit të munguar brenda afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s.

- Nga sa shqyrtuar, rezulton se është depozituar vetëm kërkesa/aplikimi drejtuar OST sh.a., ndërkohë që referuar përcaktimeve të nenit 9, pika 2, germa c, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, duhet të depozitohet miratimi i operatorit të rrjetit, e në rastin konkret nga OST sh.a.

Zgjatja e afatit të vendimarrjes

- Referuar përcaktimeve të pikave 2.2.3 dhe 2.2.4 të “Rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018, afati maksimal brenda të cilit OST sh.a. duhet të kthejë përgjigje në lidhje me pranimin ose refuzimin e një aplikimi është 90 (nëntëdhjetë) ditë.

- Duke qenë se shoqëria ka paraqitur aplikimin e saj në datën 12.8.2025, afati maksimal për të marrë një përgjigje nga OST sh.a., duke përfshirë dhe plotësimin e ndonjë dokumenti të mundshëm të munguar të aplikimit, është data 12.11.2025.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet se një akt administrativ mund të anulohet shfuqizohet apo ndryshohet kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin.

- Për sa më sipër, në rrethanat kur nuk është depozituar ende miratimi i operatorit të rrjetit, sikurse kërkuar nga rregullorja e licencimit, vazhdon të mbetet në fuqi pezullimi i procedurës, por vlerësohet ndryshimi i pikës 2, për sa i përket afatit brenda të cilit shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin e munguar, duke i lënë detyrë asaj që brenda datës 22.11.2025, të depozitojë në ERE përgjigjen e OST sh.a. për aplikimin e bërë, duke vlerësuar një kohë prej 10 ditësh për depozitimin e kësaj përgjigjeje, pas afatit maksimal brenda të cilit duhet të shprehet OST sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE nr. 148, datë 8.7.2025, ndryshon dhe bëhet:

“2. “Brenda datës 22.11.2025, shoqëria duhet të depozitojë në ERE përgjigjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. për aplikimin e bërë për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit.”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “SunPro” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti